

„PSE LUFTË? – Një reflektim mbi rendin publik të Bashkësisë Ndërkombëtare”

(Universiteti i Prishtinës: Ceremonia e ndarjes së çmimit Doktor *Honoris Causa*,
18.6.2025)

I nderuar Rektor i Universitetit të Prishtinës, Prof. Dr. Arben Hajrullahu,
Shkëlqesia e tij, Ambasadori i Kosovës në Japoni, Dr. Sabri Kiçmari,
Shkëlqesia e tij, Ambasadori i Japonisë në Kosovë, Kiminori Iwama,
Të nderuar mysafirë,
Zonja dhe zotërinj,

është nder dhe kënaqësi e madhe për mua ta marr sot çmimin Doktor *Honoris Causa* nga Universiteti i Prishtinës, institucioni akademik më i dalluar në Kosovë, për kontributin tim në shkencë dhe ushtrimin e së drejtës ndërkombëtare. Së pari do të doja t’i falënderoja të gjithë ata që kanë marrë pjesë në këtë proces.

Zonja dhe zotërinj,

I. Gjeneza e temës së diskutimit

Për mendimin tim, ne, i gjithë njerëzimi, po ballafaqohemi me sfidën më të madhe të mbijetesës sonë në histori, kriza që rendi publik i Bashkësisë Ndërkombëtare po rrezikon të shpërbëhet. Nëse shikoni skenën botërore aktualisht, një fuqi e madhe po kryen akt të qartë agresioni, duke pushtuar territorin e një shteti tjetër sovran, në kundërshtim me parimin themelor dhe shekullor të rendit publik të bashkësisë sonë. Një fuqi tjetër e madhe, duke ndjekur njëanshëm interesat e veta të ngushta ekonomike, po shkatërrojnë një kornizë shumëpalëshe të bashkëpunimit ekonomik, të ndërtuar me shumë vështirësi, që përbën një pjesë thelbësore të rendit publik të kësaj Bashkësie. Gjëja thelbësore në këtë mes është se këto akte të shkeljeve flagrante të rendit publik të Bashkësisë po ndodhin kundërt globalizimit të kësaj Bashkësie, ku kërcënimet e përbashkëta për mbijetesën

tonë, njerëzimin, siç janë kërcënimi nga ndryshimet klimatike globale ose kërcënimi nga pandemitë ngjitëse globale, po na detyrojnë të zhvillojmë dhe të ndajmë ndjenjën e fortë për fatin e përbashkët si qenie njerëzore dhe të ndërtojmë një veprim politik të unifikuar për t'u përballur me këto kërcënime.

Situata aktuale, sipas meje, na kujton në një mënyrë gjendjen e botës midis dy luftërave botërore në fillim të shekullit XX. Edhe atëherë, shfaqja e nazizmit në Republikën e Weimar-it që çoi drejt agresionit të hapur ndaj Çekosllovakisë, u shoqërua nga përmbysja e sistemit ekonomik botëror që doli si pasojë e Depresionit të Madh; kështu, efektet e tyre të kombinuara sollën një huti të plotë për rendin publik të Bashkësisë Botërore.

Nuk ishte rastësi që pikërisht në këtë kontekst historik, ndodhi dialogu i famshëm midis dy intelektualëve gjigantë të asaj kohe, fizikanit dr. Albert Einstein dhe psikanalistit dr. Sigmund Freud, për atë që ata besonin të ishte „problemi më akut” me të cilin ballafaqohej bota në atë moment. Në vitin 1931, Liga e Kombeve i bëri ofertë zyrtare Einstein, si një nga dijetarët e botës, të identifikonte problemi më akut me të cilin ballafaqohej bota në atë kohë dhe ta diskutonte atë problem me një intelektual tjetër erudit të cilin do ta zgjidhte vetë. Duke pranuar ofertën, Einstein zgjodhi Freud dhe filloi këtë dialog me anë të korrespondencës.

Zonja dhe Zotërinj,

II. Argumentet e dy shkencëtarëve të shkencave natyrore

Nuk është as koha e as vendi të hyj në ekspozë ose analizë të detajuar të diskutimit të tyre, sado interesante të jetë. Prandaj, do të kufizohem vetëm në përmbledhjen e pikëpamjeve të tyre dhe t'i ofroj komentet e mia.

Einstein ngriti çështjen në këtë mënyrë: A është e mundur të çlirohet njerëzimi nga zgjedha e luftës?

Me përparimet e mëdha në teknologji, lufta është bërë çështje që përcakton vetë fatin tonë në botën e civilizuar. Megjithatë, ende nuk është gjetur asnjë zgjidhje. Si fizikan, nuk jam i aftë të depërtoj në ndjenjat njerëzore ose në thellësinë e emocioneve njerëzore. Sidoqoftë, edhe unë, pa njohuri në psikologji, e ndjej se në mendjen njerëzore krijohen pengesa të ndryshme që parandalojnë zgjidhjen e problemit të luftës, por nuk jam në gjendje të kuptoj si ndërlidhen këto pengesa dhe ku po na çojnë ato. Besoj se ju me diturinë tuaj të thellë mund të sugjeroni mënyra për t'i hequr këto pengesa.

Për dikë që nacionalizmin e ndjen të huaj si unë, do të ishte bukur lehtë të vendosej një kornizë e jashtme për zgjidhjen e problemit të luftës. Të gjitha shtetet do të vendosnin të

bashkëpunonin për krijimin e një organizate me funksione legislative dhe gjyqësore lidhur me çështjet që ngrihen midis shteteve.

Përkundër përpjekjeve të sinqerta të një numri të madh njerëzish përgjatë shekujve, nuk është arritur paqe e përhershme. Nëse kjo është e vërtetë, nuk na mbetet tjetër veçse të vijmë deri te përfundimi se problemi i vërtetë fshihet brenda mendjes së qenieve njerëzore, që domethënë se në mendjen njerëzore ekzistojnë forca të ndryshme që u rezistojnë përpjekjeve për paqe. [Si shembull i qartë i forcave të tilla] është dëshira për pushtet ... [Kështu] një numër i vogël i njerëzve në pushtet mund të manipulojnë mendjet e një numri të madh njerëzish. [Pyetja që rrjedh nga kjo është] pse njerëzit, të nxitur nga ata në pushtet, do të lëviznin në atë drejtim? Vetëm një përgjigje më vjen në mend: në qeniet njerëzore fshihet dëshira instiktive për t'i zhdukur të tjerët nga urrejtja.

Freud në thelb e pranon qëndrimin e Einstein dhe e zgjeron argumentin duke e sjellë tërë kontekstin e çështjes në teorinë e vet si psikanalist dhe sqaron se vërtet qeniet njerëzore, si ekzistencë në procesin e evolucionit të kafshëve në botën natyrore, ruajnë instiktin e tyre si kafshë për të siguruar ekzistencën e llojit të vet. Sipas Freud, i cili e identifikon këtë instikt të qenieve njerëzore si „dëshirë”, dëshira e qenieve njerëzore përbëhet nga një element i dëshirës për jetë (eros) dhe një element i dëshirës për vdekje (tanathos) dhe kjo përzierje e dy elementeve në dëshirën njerëzore përbën forcën shtytëse që i nxit qeniet njerëzore drejt luftës.

Pasi që nuk jam ekspert i psikanalizës, nuk mund të bëj një vlerësim shkencor të analizës së tij mbi natyrën njerëzore si shkencëtar i shkencave natyrore.

Vështruar nga pikëpamja ime si shkencëtar i shkencave shoqërore, kjo analizë e Freud, e bazuar në përfundimin disi tepër të përgjithësuar të Einstein, do të ishte thjesht një interpretim hipotetik i sjelljes njerëzore i ndërtuar mbi një parim të tij hipotetik, i cili as nuk është vërtetuar e as që mund të vërtetohet, për mënyrën se si vepron instikti njerëzor. Duke supozuar se instikti i kafshës të qeniet njerëzore funksionon në mënyrën se si e parashtrohet Freud, a do të nënkuptohej pra që lufta është e pashmangshme në botën e qenieve njerëzore?

Dëshiroj ta parashtroj një çështje që mungon për të sqaruar mendimet tona lidhur me tezën „Pse Luftë?”, për të cilën Einstein dhe Freud kanë mbajtur korrespondencë. Për mendimin tim, teza e parashtrohet në formulimin e saj të përgjithësuar përmban dy pyetje të veçanta, por që janë të ndërlidhura me njëra tjetrën:

- A. Pse qeniet njerëzore si individë shtyhen drejt mosmarrëveshjeve (zënkave) me njëri-tjetrin që çojnë drejt konflikteve fizike? [Parim i përgjithshëm];
- B. Pse shtetet si trup i qenieve njerëzore janë të prirura t'i zgjidhin mosmarrëveshjet në marrëdhënie ndërkombëtare përmes luftës? [Parim specifik].

Përgjigja e së parës mund të jepet përmes analizimit të qenieve njerëzore si ekzistencë natyrore, përderisa përgjigja e së dytës mund të jepet përmes vëzhgimit të qenieve njerëzore në shoqëri. Dhe këtu qëndron dallimi në pikëpamje midis shkencëtarëve të shkencave natyrore si Einstein dhe Freud në njërin anë dhe shkencëtarëve të shkencave shoqërore si Thomas Hobbes, pikëpamjen e të cilit do ta parashtroj tani dhe unë në anën tjetër.

Zonja dhe Zotërinj,

III. Thomas Hobbes si shkencëtar i shkencave shoqërore

Pasi që qeniet njerëzore kanë evoluuar nga kafshët në botën natyrore, nuk mund të mohohet që njerëzit kanë tipare si ekzistencë biologjike, siç janë instikti për të mbijetuar dhe për pasojë, për ruajtjen e llojit të vet. Në këtë aspekt, Einstein dhe Freud kanë aryet e tyre si shkencëtarë të natyrës.

Megjithatë, Thomas Hobbes, filozof politik i Anglisë së shekullit XVI, ndërkohë që njeh anën biologjike të qenieve njerëzore se në ambientin e tyre natyror ata janë armiq për njëri-tjetrin (*homo homini lupus*), argumenton se të njëjtat qenie njerëzore (*homo sapiens*) si ekzistencë në shoqëri, udhëhiqen nga pasioni për qetësi (paqe) për dallim nga kafshët e ngjashme. Pasionet e tilla përbëjnë frikën nga vdekja, dëshirën për një jetë komode dhe aspiratën për ta arritur atë nëpërmjet punës.

Hobbes e zhvillon qëndrimin e tij si vijon:

Natyra i ka krijuar të gjitha qeniet njerëzore të barabarta në kapacitetin e tyre fizik dhe mendor.

Kjo barazi në kapacitet prodhon te ta barazinë në shpresa për t'i aritur qëllimet e tyre.

Kur ballafaqohen me situata kur nuk mund t'i arrijnë qëllimet e tyre, ata kthehen në armiq ndaj njëri-tjetrit. Kjo gjendje nuk është asgjë tjetër veçse gjendje lufte mes njerëzve. Kështu, mund t'i identifikojmë tri shkaqe kryesore të mosmarrëveshjeve që janë pjesë e instiktit natyror të qenieve njerëzore: një, konkurrenca; dy, mosbesimi dhe tre, lavdia.

Krahas pranimi se qeniet njerëzore udhëhiqen nga këto emocione që janë pjesë e natyrës së tyre të brendshme si qenie njerëzore në ambientin e tyre natyror, Hobbes e zhvillon tutje tezën e tij dhe argumenton kështu:

E gjithë kjo dëshmon se qeniet njerëzore po ashtu kanë kapacitetin të dalin nga një gjendje e tillë. Ky kapacitet konsiston pjesërisht në pasionin e tyre dhe pjesërisht në arsyen e tyre. Pasionet që i udhëheqin drejt paqes janë, siç u përmendën më herët, frika nga vdekja,

dëshira për jetë komode dhe shpresa për ta arritur atë, por arsyeja i çon drejt marrëveshjes mbi këto pasione.

Nuk është nevoja të thuhet se këto pohime të Hobbes nuk kanë për qëllim t'i adresojnë drejtpërdrejt pikëpamjet e Einstein dhe Freud. Megjithatë, përfundimet që ai i nxjerr duke u bazuar në vëzhgimet e qenieve njerëzore në shoqërinë e kohës së tij si shkencëtar i shkencave shoqërore, më duken si më pozitive si qasje dhe më bindëse në realitet.

Ajo që Hobbes kishte në mendje në argumentin e tij ishte një shoqëri, e udhëhequr nga Leviatan-i të themi, e Komonuelthit Britanik të shekullit XVII nën sundimin e Cromwell-it. Kështu, duke pohuar se qeniet njerëzore, të prirura instiktivisht ndaj mosmarrëveshjeve (luftërave), arrijnë një marrëveshje (kontratë shoqërore) për mirëqenie më të madhe (paqen) me pushtet të përbashkët (sovrantin), Thomas Hobbes u bë avokati i parë i „teorisë së kontratës shoqërore të qeverisjes”.

Zonja dhe zotërinj,

IV. Transformimi i natyrës së problemit

Mund të themi se ajo që sot e quajmë „shoqëri ndërkombëtare moderne” lindi pas përfundimit të paqes së Westphalia-s e cila i dha fund Luftës Tridhjetëvjeçare (1618 – 1648) midis katolikëve dhe protestantëve në mbarë Evropën. Kjo luftë çoi drejt rrëzimit të sistemit hierarkik të qeverisjes që dominonte në Evropë, me Papën si titullar i Perandorisë së Shenjtë Romake.

Për ta zëvendësuar këtë rend ligjor, Paqja e Westphalia-s krijoi një sistem krejtësisht të ri të qeverisjes (Rendi Ligjor Westphalian), i bazuar në parimet e sovranitetit të barabartë të shteteve anëtare të shoqërisë ndërkombëtare. Karakteristikat e tij ligjore përmblihen në parimet që:

- (A) shoqëria ndërkombëtare përbëhet prej shteteve sovrane;
- (B) shtetet sovrane kanë të drejtë në barazi sovrane, pa marrë parasysh madhësinë e territorit, popullsinë, dhe forcën ushtarake;
- (C) nuk lejohet kurrfarë ndërhyrjeje në çështjet e brendshme të shteteve tjera sovrane, dhe
- (D) forca normative e rregullave që i detyrojnë shtetet sovrane në këtë shoqëri do të varet nga pëlqimi apo marrëveshja e tyre.

Pasi që kjo natyrë detyruese buron nga vetëpërmbajtja për të vepruar e shteteve sovrane dhe jo nga një autoritet më i lartë i shoqërisë, ky sistem nganjëherë quhet „sistem anarkik

i qeverisjes” ose sistem johierarkik i qeverisjes pasi që nuk ka një super-sovran hierarkik në majën e rendit.

Ky sistem johierarkik i qeverisjes mund të duket si sistemi Hobbes-ian i qeverisjes, pasi që të dy fillojnë me premisën se anëtarët e shoqërisë janë të lirë dhe të barabartë. Në këtë kuptim, të dy sistemet mund të quhen *rend utopik*. Megjithatë, dallimi kryesor i Rendit Ligjor Westphalian është se ai bazohet në premisën përshkruese se shtetet sovrane duhet të jenë të barabarta kundrejt realitetit politik të dallimit të tyre në madhësinë e territorit, popullsisë dhe forcës ushtarake, kurse te Hobbes, teoria e tij bazohet në atë që ai e perceptonte si realitet faktik që Natyra i krijoi qeniet njerëzore të barabartë fizikisht dhe mendërisht dhe vazhdon to argumentojë se ata janë të prirur për zënka nga instikti dhe se nevojitet një super-autorit hierarkik (Leviatani - një përbindësh në Testamentin e Vjetër) për të sjellë rend në shoqëri.

Është e mundur që Paqja e Westphalia-s ishte menduar për ta çliruar shoqërinë evropiane pas valës së reformimit nga zgjedha e Leviatani (Papës) dhe se ky sistem i ri johierarkik i qeverisjes i krijuar në Westphalia ishte menduar për ta formësuar një rend të ri ligjor të bazuar në parimet e barazisë sovrane si kornizë e re për marrëdhëniet ndërkombëtare. Sidoqoftë, nuk mund të mohohet se ky sistem i ri jo-ierarkik i qeverisjes ka shërbyer si një kornizë justifikuese (apologjetike) për marrëdhëniet ndërkombëtare, duke ua mundësuar shteteve sovrane ushtrimin e lirisë së pakufizuar të veprimit, përveç vetëpërmbajtjes së tyre, pa ofruar ndonjë garanci efektive për të parandaluar sovranin që, siç e theksoi me të drejtë Hobbes, ka instinkt për mosmarrëveshje (luftëra).

Duke marrë parasysh që mosmarrëveshja është e pashmangshme në shoqërinë njerëzore, siç supozon Hobbes, mbetet ende për t’u shqyrtuar nëse kjo çon automatikisht drejt përdorimit të pashmangshëm të asaj që Freud e përshkruan si përdorimi i „Gewalt” (forcës së pushtetit), pra luftës. Unë them se ky rezultat buron më shumë nga karakteristika e veçantë e Rendit Ligjor Westphalian. Në rendin vendor ligjor, duke lënë mënjanë fazën primitive (ku „hakmarrja me gjak” ishte pjesë e jetës), një mosmarrëveshje e tillë e pashmangshme ndërmjet njerëzve i kalohet autoritetit, „Macht” (pushtetit), të shtetit që ushtron autoritet në vend të qenieve njerëzore që e përbëjnë atë shtet, përmes uzurpimit (diktaturës) të tij, besimit (kontratës shoqërore) të tij ose përfaqësimit (demokracisë) të tij të autoritetit nga qeniet njerëzore, varësisht nga rasti. Kjo na çon në përfundimin se pyetja „Pse Luftë?” shkon përtej analizës së natyrës së brendshme njerëzore.

Zonja dhe zotërinj,

V. Problemët karakteristike të Rendit Westphalian

Kur trajtonte natyrën njerëzore, Hobbes i referohej arsyeshmërisë së qenieve njerëzore paralelisht me pasionet e tyre. Megjithatë, kur diskutonte situatën në të cilën akterët nuk janë qenie individuale njerëzore si pjesë e shoqërisë, por shtete sovraane si anëtarë të shoqërisë, çështja se si virtyti i arsyes te qeniet njerëzore mund të funksionojë për të penguar mosmarrëveshjet e shteteve të shndërrohen në luftëra, merr një dimension më të gjerë sesa çështja e arsyes njerëzore si një „element karakteristik i natyrës njerëzore”, që Hobbes theksonte në kontekstin e tij.

Guxoj të sugjeroj se Paqja e Westphalia-s, duke krijuar një sistem të ri të qeverisjes së shoqërisë ndërkombëtare në Evropën e shekullit XVII, sado e pashmangshme apo e domosdoshme të ketë qenë për ta realizuar paqen e përhershme në rajon, ka lënë një gjurmë të pashlyeshme në tërë historinë e botës deri në ditët e sotme, për shkak të një zhvillimi të rastësishëm historik, nëpërmjet të cilit ky sistem i qeverisjes që mbizotëronte në botën evropiane ka filluar të zbatohet në botën e globalizuar si një sistem i qeverisjes i bashkësisë ndërkombëtare që aplikohet në mënyrë universale. Mënyra se si të kapërcehet paradoksi që ky sistem anarkik i qeverisjes paraqiste është shndërruar në agjendë të re me të cilën është dashur të ballafaqohet bashkësia ndërkombëtare.

(1) Së pari, nuk ka dyshim që bashkësia ndërkombëtare duhet të ketë një rend minimal publik *qua society*, d.m.th., një kornizë normative rregullash të cilat i detyrojnë anëtarët e veta, shtetet sovraane (*ubi societas ibi ius*). Në këtë sistem anarkik të Rendit Ligjor Westphalian, këto rregulla krijohen me pëlqimin vullnetar të shteteve sovraane (në bazë të *pacta sunt servanda*, norma bazë e këtij sistemi). Ndalimi i përdorimit të luftës, ose forcës ndaj një shteti tjetër mund të përfshihet në një normë të tillë si pasojë e parimit themelor të barazisë sovraane. Në fakt, fuqia absolute e shtetit sovran e përforcuar nga pabarazia faktike midis shteteve i shtyn shtetet të përdornin maksimalisht sovranitetin e tyre në marrëdhëniet ndërkombëtare. Kur Carl von Clausewitz, gjeneral i Napoleonit dhe strateg i shekullit XIX, tha se „lufta është vazhdim i diplomacisë me mjete tjera” në librin e tij „Mbi Luftën” [„Vom Kriege”], ky mendim u pranua si mençuri e shëndoshë e sjelljes së jashtme të shteteve sovraane. Kjo filozofi pashmangshme e çoi shoqërinë ndërkombëtare në fund të shekullit XIX drejt justifikimit të doktrinės me të cilën shtetet e fuqishme mund të silleshin sikur „lufta të ishte vegël legjitime e shtetit për ta imponuar vullnetin e vet mbi armiqtë (Clausewitz, *ibid*)”.

(2) Paradoksi i dytë në këtë sistem të qeverisjes është që shtetet sovraane, në pronësi të kësaj vegle legjitime të diplomacisë, nuk hezitonin të përdornin luftërat dhe të

shkatërronin jetërat e njerëzve të pafajshëm. Luftërat e mëdha shpesh goditën kontinentin evropian në pjesën e dytë të shekullit, si Lufta Ruso-Turke, Lufta e Krimesë, Lufta Franko-Prusiane dhe Lufta për Unifikimin Italian. Këto zhvillime tronditën ndërgjegjen e njerëzve për shkak të mizorive dhe karakterit çnjerëzor. Zëri i arsyes dhe etikës filloi të mbizotëronte mbi fuqinë e instiktit dhe logjikës njerëzore. Ajo që doli nga kjo situatë paradoksale çoi në pranimin, përmes marrëveshjeve vullnetare, të disa rregullave normative për mbrojtjen humanitare që lidhen me *jus ad bellum* dhe *jus in bello*, si dhe Traktatin për Zgjidhjen Paqësore të Mosmarrëveshjeve të vitit 1898 në Konferencën e Parë të Paqes në Hagë. Megjithatë, kjo lëvizje ishte shumë larg ndalimit të luftës përmes marrëveshjes vullnetare.

(3) Aspekti i tretë i këtij paradoksi të natyrshëm në sistemin anarkik të qeverisjes qëndron në mungesën e autoritetit zbatues që mund ta detyrojë shtetin sovran t'i respektojë rregullat që vetë i ka pranuar. Në sistemin anarkik të qeverisjes si në shoqërinë vendore, autoriteti më i lartë i shtetit është i pajisur me mjetet e nevojshme për zbatim, si policia apo gjyqësori, për ta ruajtur rendin publik të shoqërisë. Në këtë sistem anarkik të qeverisjes, edhe pse është në fuqi norma themelore *pacta sunt servand*, shteti mund të veprojë sipas dëshirës pa u ndëshkuar. Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë, organi kryesor i shoqërisë ndërkombëtare i pajisur me kompetenca për të shqyrtuar mosmarrëveshjet midis shteteve, nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë pa pëlqimin specifik të palëve të përfshira dhe nuk mund ta zbatojë vendimin e saj në rast se palët vendosin të mos e respektojnë atë. Një zgjidhje kompromisi për ta plotësuar këtë mangësi fatale është sistemi i pranimi vullnetar të jurisdiksionit të detyrueshëm të Gjykatës sipas nenit 38 të Statutit të saj, si dhe fuqia e Këshillit të Sigurimit për të ndërmarrë masa për zbatimin e vendimit sipas nenit 48 të Kartës së Kombeve të Bashkuara. Por këto nuk janë masa të detyrueshme për të siguruar pajtueshmëri.

(4) Pika e katërt dhe e fundit që duhet ngritur për ta vlerësuar problemin „Pse Luftë?” është fakti që akterët realë të mosmarrëveshjes/luftës nuk janë të njëjtë si në kontekstin vendor ashtu edhe në atë ndërkombëtar. Në rastin e parë, mosmarrëveshjet mund të lindin në mënyrë të pashmangshme midis individëve, por mbetet në duart e tyre se si do t'i zgjidhin ato. Në rastin e dytë, akterët realë të mosmarrëveshjeve janë shtetet sovraane dhe vullneti i shtetit në fjalë përfaqësohet nga autoriteti i tij sovran që mund të mos e përfaqësojë vullnetin e njerëzve që jetojnë nën këtë autoritet. Vendimet se si dhe me çfarë mjeteve do të vendoset për këto mosmarrëveshje apo nëse është arritur pika kur lufta është e pashmangshme dhe nuk ka hapësirë për diplomaci, janë në duar të vendimmarrjes sovraane të shtetit. Duke iu referuar kësaj situatë të mundshme të mospërputhjes, Immanuel Kant, filozof prusian i fundit të shekullit XVIII, bëri vërejtjet e mëposhtme në traktatin e tij „Zum Ewigen Frieden” („Për paqen e përherëshme”). Në rastin kur kërkohet miratimi i popullit nëse do të hyhet apo jo në luftë, është krejtësisht e natyrshme që njerëzit, të cilët duhet të jenë të përgatitur të përballojnë të gjitha barrat

e dhimbshme të luftës, të tregohen tepër të kujdesshëm. Në një regjim politik ku njerëzit e shoqërisë nuk përbëjnë subjektin e sovranit, pra një regjim që nuk është republikan, zhvillimi i luftës është ngjarje e përditshme që nuk kërkon kujdes të veçantë. Kjo ndodh sepse atje sovrani nuk është pjesë përbërëse e shtetit, por është vetë pronari. Ai vendos për nisjen e luftës njësoj siç vendos për të luajtur një lojë.

Zonja dhe zotërinj,

VI. Komentë përmbyllëse

Ajo çfarë thashë në diskutimin tim për temën „Pse Luftë?” mund t’ju tingësojë si tepër alarmuese dhe tejet provokative. Nëse është kështu, më kënaq reagimi juaj, sepse qëllimi im ishte t’ju nxisja të mendoni e të reflektoni më shumë sesa të më dëgjoni dhe të mësoni nga unë.

Megjithatë, nuk është qëllimi im t’ju lë me pikëpamje pesimiste për të ardhmen tonë.

E dëgjuat nga unë se nuk e ndaj pesimizmin e Einstein dhe Freud. Ata, si shkencëtarë të shquar të shkencave natyrore, kanë analizuar shkëlqyeshëm instiktin e brendshëm të qenieve njerëzore në mjedisin e tyre natyror, por dëshiroj t’ju kthej te një aspekt i historisë së gjatë të njerëzimit. Në mungesë të një shprehjeje më të mirë, këtë e quaj „vala e historisë”. Në thelb, kjo është mençuria e grumbulluar e qenieve njerëzore si *homo sapiens* që ka ndërtuar shoqërinë njerëzore përmes historisë. Në perspektivë afatgjate të historisë njerëzore, ne kemi arritur suksese dhe kemi bërë gabime dhe kemi nxjerrë mësim nga to.

Globalizimi i botës, na pëlqeu apo jo, është një valë e tillë e historisë, dhe ne duhet t’ia përshtasim sistemin tonë të qeverisjes këtij realiteti. Një mënyrë për ta realizuar një përshtatje të tillë do të ishte ta ndjekim Hobbes dhe ta formësojmë bashkësinë ndërkombëtare në një të tillë që do të qeverisej nga Leviatani. Kjo hipotezë, në fakt, do të nënkuptonte themelimin e qeverisë botërore. Nuk do ta përjashtoja këtë mundësi në një të ardhme të largët, por fuqitë e mëdha botërore nuk ka gjasa ta pranojnë një zhvillim të tillë, përveçse në një situatë të paparashikueshme ku hegjemonia e një fuqie të vetme të arrinte në atë pikë sa ta fitonte fuqinë e një *Leviatani*.

Paralelisht me globalizimin e bashkësisë, ne gjithashtu jemi dëshmitarë të humanizimit të kornizës normative të bashkësisë. Ky është një manifestim tjetër i valës së historisë.

Sa i përket mbrojtjes së qenieve njerëzore individuale, kemi parë më herët se kah fundi i shekullit XIX, mizoritë që janë ushtruar mbi qeniet njerëzore të pafajshme detyruan shtetet sovrane të pranonin rregullat e të drejtës ndërkombëtare humanitare në formë të

konventave të dakorduara nga to. Përderisa Pakti Kellogg-Briand i vitit 1928 nuk mundi ta parandalonte Luftën e Dytë Botërore, krijimi i Kombeve të Bashkuara me mekanizmat e veta për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, së bashku me miratimin e Konventës së Gjenevës si pasqyrim i ndërgjegjes njerëzore kundër mizorive të holokaustit, ka shtruar rrugë për të kaluar nga „bashkësia ndërkombëtare e përqendruar te shtetet sovrane” te „bashkësia njerëzore e përqendruar te njeriu”. Themelimi i Gjykatës Ndërkombëtare Penale mund të shihet si manifestim i kësaj vale të historisë.

Në dritën e kësaj vale të historisë, ajo që ju keni arritur në Kosovë mund të vlerësohet si një fitore njerëzore më shumë sesa një fitore ndërmjet kombeve. Me këtë koment, dëshiroj ta përmbyll prezantimin tim.

Zonja dhe zotërinj,

Falemnderit për vëmendjen tuaj për këtë diskutim paksa të zgjatur mbi „Pse Luftë?”

Hisashi Owada,

Ish kryetar i Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë.

Përktheu dhe përshtati nga gjuha angleze: Zinaide Gruda

Për versionin në gjuhën shqipe u kujdesën: Arben Hajrullahu dhe Bekim Muhaxheri.